



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **GAZETARI**

**Lënda: Qytetërimi europian**

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Andi Pinari
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 2 orë leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

**Përshkrimi:** Qytetërimi perëndimor është një nga qytetërimet më të rëndësishme përgjatë zhvillimit historik të njerëzimit. I lindur në pellgun mesdhetar ky qytetërim u shfaq në Greqinë e lashtë duke arritur një fazë zhvillimi të konsiderueshëm në raport me qytetërimet e tjera. Pas Greqisë qytetërimi vazhdoi mbi baza të forta përhapjen e thelbit të tij tek Roma, duke zhvilluar edhe një sërë aftësish të tjera që do të ndikojnë në mënyrë të pakthyeshme të gjithë europianët. Periudha mesjetare ishte një moment delikat në vazhdimësinë e tij duke shfaqur probleme të reja për Europën por njëkohësisht duke u orientuar drejt zgjidhjeve të reja të këtyre problemeve. Ndërsa proceset e Rilindjes, reformës fetare dhe zbulimeve gjeografike i dhanë Europës një hov të ri zhvillimi por edhe zgjerimi të ndikimit të panjohur ndonjëherë më parë. Konceptet e reja mbi shkencën, fenë, rolin e individit, strukturat politike filluan të jenë gjithmonë e më tepër vendimtare në lëvizjet e shumta shoqërore, politike dhe ekonomike. Një moment tjetër përcaktues kanë qenë edhe revolucionet liberale të cilat i dhanë këtij qytetërimi strukturën e sotme dhe e bënë atë të marrë një rol drejtues në zhvillimet globale.

**Temat e leksioneve:**

1. Kuptimi i nocionit të qytetërimit. Qytetërimi dhe kultura. Raportet e qytetërimit me shoqërinë dhe ekonominë.
2. Rrënjët historike të qytetërimit europian Qytetërimi i lashtë grek. Trashëgimia greke në fushat politike dhe kulturore.
3. Qytetërimi romak Shndërrimi i Romës në perandori të përbotshme. Shoqëria, institucionet shtetërore, arti dhe kultura në Romën e lashtë.
4. Përhapja e Krishtëritimit. Krishtërimi si faktor kulturor i Europës.
5. Qytetërimi bizantin Zhvillimet politike dhe shoqërore në Perandorinë Romake të Lindjes (Bizanti). Kultura dhe arti bizantin Krishtërimi lindor (Orthodoksia)
6. Shoqëria feudale në Europë. Tipare të strukturës shoqërore në Europën mesjetare
7. Rritja dhe fuqizimi i mbretërive kombëtare në Europë. Vdekja e Zezë dhe rrjedhojat e saj shoqërore. Kisha në Mesjetën e Vonë
8. Rilindja europiane. Humanizmi. Zbulimet e mëdha gjeografike. Përtëritja e mbretërive në Europë.

9. Periudha e Reformacionit në Europë. Reformacioni në Gjermani, Zvicër, Angli dhe vende të tjera europiane. Kundër-reformacioni.
10. Dy modele të zhvillimit politik të Europës së shek.XVII : Konstitucionalizmi dhe Absolutizmi. Oliver Kromuelli dhe "Republika Puritane" në Angli. Vendosija e monarkisë absolute në Francë.
11. Iluminizmi europian. Mendimi shkencor i periudhës së iluminizmit. Iluminizmi dhe shoqëria
12. Shoqëria dhe ekonomia në Europën e shek.XVIII. Revolucioni në bujqësi. Revolucioni i parë industrial Qytetet. Revolucioni i dytë industrial
13. Kriza e feudalizmit në Francë. Revolucioni francez i vitit 1789. Reformat antif feudale në Francë dhe jehona e tyre. Perandoria e Napoleon Bonapartit
14. Nacionalizmi romantik dhe historia . Liberalizmi dhe socializmi.
15. Pozitivizmi, darvinizmi dhe modernizmi. Imperializmi perëndimor në fund të shek. XIX.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Angazhimi dhe pjesëmarrja :	10% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	90% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. F. Braudel, *Gramatikë e qytetërimeve*, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë 2005
2. Cikël leksionesh i përgatitur nga Prof.Dr. Ferit Duka

#### **Literatura plotësuese:**

1. N. Rich, *Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914*, Toena, Tiranë 2006
2. N. Rozenberg, L.E. Bërdzell, *Si u pasurua perëndimi, transformimi ekonomik i botës industriale*, Elena Gjika, Tiranë 1995.